

PROCEDURA PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË ELEKTRONIKE DHE PËRDORIMI I SAJ

Të gjithë tatimpaguesit duhet të marrin masat e duhura me qëllim që të përmbushin detyrimet Ligjore, referuar Ligjit Nr. 87/2019 “Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit”.

Që nga data 1 Janar 2021, faturat që do të lëshohen për Organet Publike Shtetërore duhet të jenë Fatura Elektronike dhe shkëmbehen nëpërmjet Platformës Qendrore të Faturave.

Ndërsa për faturat që do të lëshohen ndërmjet tatimpaguesve, këto fatura duhet që të jenë Fatura Elektronike dhe shkëmbehen nëpërmjet Platformës Qendrore të Faturave duke filluar nga data 1 Korrik 2021.

Për të lëshuar Faturë Elektronike kërkohet që tatimpaguesit të përmbushin kërkesat si më poshtë:

- Akses në Internet në vendin e lëshimit të faturave elektronike
- Pajisja me Certifikatë Elektronike nga Agjensia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Shërbimi: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13691

Aplikim për certifikatë elektronike për projektin e fiskalizimit



Kontaktet

Tel: +355 42 277 750
E-mail: info@akshi.gov.al
Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II" Nr. 3 Tiranë

Aplikim për certifikatë elektronike për projektin e fiskalizimit

Shërbimi elektronik "Aplikim për certifikatë elektronike për projektin e fiskalizimit" mundëson pajisjen me Certifikatë Elektronike për subjektet tatimpaguese në kuadër të projektit të fiskalizimit. Kjo certifikatë digjitale është e lidhur në mënyrë unike me biznesin si entitet.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.673, datë 22.11.2017, "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", si dhe nenit 19, ligjit nr.9980, "Për Nënshkrimin Elektronik" i ndryshuar, si dhe në mbështetje të ligjit nr.107/2015, "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara" i ndryshuar, AKSHI zhvillon, administron, mirëmban Infrastrukturën e Çelësit Publik (PKI) dhe menaxhon Certifikatat Elektronike X.509 v3.

Dokumentacioni i nevojshëm

Për këtë shërbim nuk nevojitet dokumentacion shoqëruar.

✓ Lexo më shumë

PËRDOR

Klikoni në butonin "PËRDOR"


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

I. Të dhënat e subjektit ⓘ

NIPT : L42202028V

Subjekti : JEHONA SOFTWARE

Email ⓘ : k.zyberi@jehona.al

Tel ⓘ : 0686079550

Përfaqësues : Klodian Xhemal Zyberi |

Adresa : Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Prokop Mima, Pallati Universal, Hyrja e Pare, Kati i Pare, Hyrja 1 A,Tirane,TIRANE,Tirane

II. Qyteti

Qyteti: ⓘ Tirana ▼

III. Mënyra e pagesës

Mënyra e pagesës: ⓘ ☒ Mandatpagesë ☐ Pagesë Online

Vazhdo me mandatpagesën

Në këtë formë duhet të verifikoni të dhënat, të caktoni qytetin në të cilin operon subjekti, dhe përcaktoni mënyrën e pagesës.

Nëse përcaktohet mënyra e pagesës “Mandatpagesë” atëherë do të shfaqet forma për të shkarkuar “FATURËN PËR ARKËTIM” si dhe të ngarkoni pagesën e kryer në bankë, si më poshtë:


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mandatpagesa ⓘ

Shkarko faturë pagesë për certifikatë elektronike për projektin e fiskalizimit

Ngarkoni dokumentin:

Përzgjidh... Ngarko

Anullo | Përfundo aplikimin

FATURË PËR ARKËTIM

Numër _____ Datë _____

Me anë të kësaj fature kërkohet që Banka e Nivelit të Dytë të pranojë nga klientë (persona/ persona fizik/ persona juridik) arkëtime të të ardhurave, për llogari të institucionit tonë, me emërtime, kode dhe shuma si më poshtë:

Emri i institucionit përfitues Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
 Nipti K72301452S
 Kodi i institucionit përfitues 1087006
 Kodi i Degës së Thesarit ku vepron 3535

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma që arkëtohet (lekë)
	Emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	
1	Te ardhura për pajisje me certifikate për projektin e fiskalizimit	4665100	4000
2			
3			
4			
5			
	TOTALI		4000

INSTITUCIONI _____ KLIENTI _____

FATURË PËR ARKËTIM

Numër _____ Datë _____

Me ngarkimin e dokumentit të pagesës, do të përfundoni aplikimin tuaj duke klikuar në butonin “Përfundo aplikimin” dhe më pas do të merrni certifikatën tuaj me email nga AKSHI.

Certifikata elektronike L42202028V Inbox x

njoftime.pki@akshi.gov.al
to me

Përshëndetje Z. JEHONA SOFTWARE,

Ju njoftojmë se certifikata elektronike në kuadër të sistemit të fiskalizimit për subjektin tuaj është gjeneruar me sukses. Këtë certifikatë elektronike mund ta gjeni bashkëngjitur këtij e-maili. Fjalëkalimi i kësaj certifikate është 1234. Për odo pyetje apo paqartësi rreth certifikatës elektronike lutemi të na kontaktoni në adresën e e-mail: pki@akshi.gov.al.

Faleminderit,

Sektori i Infrastrukturës së Çelesave Publik
Drejtoria e Sigurisë e-Gov
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit



Rr. Papa Gjon Pali i II, Nr 3, 1003 Tiranë, Shqipëri
Web: www.akshi.gov.al
Email: pki@akshi.gov.al

*Ky është një email automatik. Ju lutem mos iu përgjigjini këtij email-i!

...


[Message clipped] [View entire message](#)




cert_20201221161...

Nëpërmjet këtij email ju do të informoheni për fjalëkalimin e certifikatës elektronike si dhe do të mund të shkarkoni certifikatën elektronike e cila ndodhet bashkëlidhur këtij email.

- c. Aksesimi i Platformës Qëndrore të Faturave duke përdorur kredencialet tuaja të aksesit nëpërmjet E-Albania, në adresën: <https://efiskalizimi-app.tatime.gov.al/self-care>




Duke pranuar “Termat dhe Kushtet” e përdorimit të Platformës Qëndrore të Faturave ju mund të klikoni mbi linkun “**Identifikim nëpërmjet E-Albania**”, link i cili mundëson identifikimin tuaj nëpërmjet E-Albania:




Pas identifikimit të saktë me kredencialet e E-Albania ju do të mund të përdorni Platformën Qëndrore të Faturave.

d. Ngarkimi i Certifikatës Elektronike

Për të përdorur Platformën Qendrore të Faturave në lëshimin e Faturave Elektronike duhet të ngarkoni Certifikatën Elektronike në menunë ***“Fatura elektronike”*** → ***“Informacioni i Certifikatës Elektronike”***



Më pas do të ngarkoni certifikatën elektronike të dërguar nga AKSHI:



Më pas klikoni në butonin “Ruaj” / “Save” për të kaluar në hapin tjetër që lidhet me verifikimin e kësaj Certificate Elektronike dhe ndryshimit të fjalëkalimit që u ka ardhur nga AKSHI (shembull në email më lart është fjalëkalimi: 1234)

*** Kujdes: Lutem të ruani me kujdes fjalëkalimin e ri të certifikatës elektronike që do të vendosni**

CERTIFIKATA ELEKTRONIKE



Emri i përdoruesit: JEHONA SOFTWARE
NIPT: L42202028V

☐ Përdoruesi përdor ERP dhe aplikacionin


 Certifikata elektronike u ngarkua


 Ngarko çelësin e ri


 Certifikata elektronike e pavliduar

Fjalëkalimi i vjetër:

Fjalëkalimi i ri:

Konfirmo fjalëkalimin e ri:

Fjalëkalimi i ri nuk është i njëjtë


 Verifiko certifikatën elektronike

Pas verifikimit të certifikatës elektronike do të merrni mesazhin që ***“Certifikata elektronike e validuar”***

Username: JEHONA SOFTWARE
Nuis: L42202028V

☐ User using ERP and application


 Key archive uploaded


 Key archive verified

Initial password:

New password:

New password again:


 Upload new key


 Verify key

e. Plotësimi i të dhënave për procesin e fiskalizimit sipas nënpikave:

- Përcaktimin e ofruesit të internetit për vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit
- Përcaktimin e pronësisë së ambjentit dhe sipërfaqes për vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit
- Përcaktimin e rregullit të numrit rendor të faturave
- Përcaktimin e aktiviteteve të biznesit referuar kodeve NACE Rev. 2
- Përcaktimin e orëve të punës për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit
- Përcaktimin e koordinatave në hartë për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit
- Shtimin e kontakteve për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit

- Shtimin e operatorit/ëve që do të lëshojë faturë elektronike
- f. Ngarkimin e Certifikatës Elektronike me qëllim fillimin e procesit të lëshimit të faturave elektronike

Me plotësimin e kërkesave të cituara më lart, ju tashmë mund të lëshoni fatura elektronike nëpërmjet Platformës Qendrore të Faturave për Organet Publike Shtetërore.

Për më shumë ju mund të referoni edhe faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në adresën: <https://www.tatime.gov.al/c/424/fiskalizimi>